





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



No. 01-400/01-005/683/20
Data 09-12-2020



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

RREGULLORE PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

SKENDERAJ
Nëntor 2020

Në bazë të nenit 12 paragrafët 1 dhe 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, nenit 36 paragrafi 3 të Rregullës Financiare Nr.01/2013-MF - Shpenzimi i Parave Publike, Rregullore MF- Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardët dhe procedurat e Financimit Publikë të OJQ-ve, dhe sipas nenit 14 paragrafët 1 dhe 2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2020 miratoj këtë:

R R E G U L L O R E N P Ë R N D A R J E N E S U B V E N C I O N E V E

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Më këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat për ndarjen e mjeteve financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve, në fusha të cekura për persona fizik dhe juridik në Komunën e Skenderajt.

Neni 2 Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim si në vazhdim:

Subvencione - nënkupton pagesë financiare të njëhershme, të pa kthyeshme të cilat i ndahen personave fizik dhe juridik nga buxheti i Komunës së Skenderajt.

Person fizik - nënkupton qytetarin me identitet sipas të dhënave të regjistrave të gjendjes civile.

Person juridik -- nënkupton ndërmarrjen, entin, shoqatën, Klubin Sportiv Publikë me identitet sipas të dhënave të regjistrave të personave juridik.

Thirrje publike -- nënkupton njoftimin publik për pranimin e aplikacioneve.

Pagesa e pa kthyeshme -- është e një anshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim për pagesën.

Përfitues -- nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e Komunës.

Banor Rezident -- nënkupton personi që jeton e vepron në Komunë, dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Komision -- nënkupton anëtarët e emëruar nga Kryetari i Komunës për vlerësimin e kërkesave dhe ankesave të parashtruara për subvencionim.

Neni 3 **Limitet buxhetore**

1. Komuna ndan subvencione në masën e përcaktuar, bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal.
2. Komuna ndan subvencione për këto fusha: arsim, zhvillim ekonomik, bujqësi, shëndetësi, mirëqenie sociale, kulturë rini dhe sport, si dhe duke mos u kufizuar edhe në fushat tjera.
3. Ndarja e subvencioneve prej pesëqind (500 €) euro, OJQ-të, ndërsa për personat fizik deri në dy mijë e pesëqind (2500 €) bëhet me kërkesë të personave fizik dhe juridik me arsyetim nga drejtoria përkatëse, nxjerr vendim Kryetari i Komunës.

Neni 4 **Parimet e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve**

1. Komuna ndan subvencioneve për persona fizik në bazë të kërkesës së arsyetuar, dhe për persona juridik sipas thirrjes publike në pajtim me dispozitat e kësaj Rregullore.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike, përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informatat e tjera me rendësi.
3. Përfitues të subvencioneve janë personat fizik dhe juridik, të cilët nuk kanë obligime financiare ndaj Komunës, përveç rasteve sociale, fatkeqësive natyrore dhe rasteve të renda shëndetësore.
4. Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve të tjera ndaj personit fizik dhe juridik mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vet Komuna.

Neni 5 **Përjashtimet nga ndarja e subvencioneve**

1. Përfitues të subvencioneve nuk mund të jenë personat fizik jo rezident të Komunës.
2. Përfitues i subvencioneve mund të jetë vetëm një herë në vit personi fizik dhe juridik, me përjashtim të rasteve për personin fizik në fushën e shëndetësisë, për nevoja të shërimit dhe sigurimit të ushqimieve (mirëqenie sociale) dhe në fushën e bujqësisë.

3. Çdo person fizik dhe juridik humbe te drejtën e pjesëmarrjes ne mbështetje te projekteve te tyre qofte permes thirrjes publike apo me vendim te Kryetari të Komunës nëse:

- Obligimet e përcaktuara në kontratë për ndarjen e subvencioneve nuk përmbushen nga mos përgjegjësia e përfituesit.
- Nuk e mbyllë me raport sipas kontratës shumën e fituar.
- Nuk e ka përmbyll subvencionin paraprak me raport.
- Nuk e realizon projektin sipas te cilit ka aplikuar në thirrjen publike brenda vitit kalendarik.
- Nuk i është pranuar realizimi i projektit nga zyrtarët e DKRS-së apo çdo zyrtar tjetër komunal i caktuar menaxher apo mbikëqyrës i kontratës.
- Përfituesi e përdor subvencionin ne kundërshtim me projektin (realizon një tjetër projekt) qe ka qene përfitues ne thirrjen publike.
- Nuk raporton ne periudha ditore mujore e me gjatë varësisht për sa kohe zgjate implementimi i projektit dhe sipas formës te deklaruar ne thirrjen publike por nuk mund te jete me e gjatë se tetëmbëdhjetë (18) muaj.
- Nuk i kthen ne komunë mjetet financiare për projektet e dështuara (mos realizimi) minimalisht shumën shtatëdhjetë (70%).

3.1 Çdo person fizik dhe juridik qe është përfitues i subvencioneve komunale humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve për 3 (tre) vitet e ardhshme nëse bie ndesh me legjislacionin ne fuqi, dhe me këtë rregullore.

Neni 6 Komisioni vlerësues

1. Kryetari i Komunës konform legjislacionit në fuqi emëron komisionin vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve dhe kërkesave për ndarje te subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.
2. Komisioni vlerësues përbëhet nga 5 anëtar më përfaqësim gjinor dhe njëri nga të cilët duhet të jetë zyrtar për buxhet/financa, anëtarët mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë për ndarje të subvencioneve.
3. Përveç anëtarëve të rregullt duhet të emërohet edhe një anëtar rezervë i cili do të zëvendësoj anëtarin tjetër në rast konflikt interesi, sipas të Ligjit, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
4. Komisioni Vlerësues sipas kësaj rregulloreje është përgjegjës për:
 - a. Zbatimin e kësaj rregulloreje siç parashihet tek neni 5 pika 3 për ish përfituesit ndërsa për kriteret tjera siç parashihet ne normativen tjetër si dhe legjislacioni tjetër ne fuqi
 - b. Zgjedh nga radhët e veta kryetarin e Komisionit.
 - c. Thirrjen Publike

- d. Kriteret e konkurrimit
- e. Fushat e thirrjes te specifikuara me shuma te mjeteve financiare për secilën fushë sipas prioriteteve (Kultura, Rinia, Sporti) dhe buxhetit komunal.
- f. Përkujdeset që në kritere të mos ketë pabarazi gjinore fetare e racore.
- g. Të beje publikimin e mënyrës së vlerësimit për secilën fushë e secilin projekt.
- h. Harton tabelës së poentimit për projektet në secilën fushë konkurruese.
- i. Ruan parimin e transparencës
- j. Ruan parimin e ligjshmërisë
- k. Trajtimin e barabartë të konkurruesve, personave fizik dhe juridik.
- l. Ruan parimin e llogaridhënies për vlerësim të projektit.
- m. Secili anëtarë i komisionit është autonom në vlerësim të projekteve konkurruese.
- n. Përpilojnë raport me shkrim mbi bazën e tabelës së poentimit për secilin aplikacion veç e veç secili anëtarë i komisionit.
- o. Zgjatë afatit për konkurrim.
- p. Cakton kohën për kompletim të dokumentacionit për pjesëmarrësit në thirrje publike
- q. Publikon listën e përfituesve dhe të jo-përfituesve.
- r. Njofton pjesëmarrësit në thirrje publike me shkrim për vendimin e komisionit, secili veç e veç për ndarjen apo jo të subvencionit
- s. Cakton afatit të ankesave për persona fizik dhe juridik pjesëmarrës në thirrje publike të cilët nuk pajtohen me vlerësimin e komisionit
- t. Komisioni kryen punën e vetë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga dita e mbylljes së afatit për aplikim në thirrjen publike.
- u. Për punën e vet me raport të shkruar me specifikacion për secilin aplikues i raporton kryetarit të komunës, raport të cilin e publikon pas përfundimit të afatit të ankesave në çdo thirrje publike

Neni 7

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja

1. Komisioni bën vlerësimin e aplikacioneve pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë pas mbylljes së thirrjes publike për persona fizik dhe dhjetë (10) deri në tridhjetë (30) ditë pas paraqitjes së kërkesës të personit juridikë.

Komisioni mban procesverbal gjatë tërë procesit të vlerësimit, deri tek marrja e vendimit.

2. Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve, sipas listës përfituese të komisionit vlerësues për persona fizik, ndërsa për OJQ-të vendimin e nxjerr komisioni vlerësues sipas renditjes së pikëve, në afat prej pesë (5) ditë pune pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave, të përcaktuara sipas nenit 10 të kësaj rregullore.

3. Kryetari mund të kërkojë nga komisioni vlerësues të bëjë rivlerësimin e kërkesave, apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktoj komision të ri për vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve.

Neni 8 Komisioni i Ankesave

1. Kryetari i Komunës emëron komisionin e ankesave në përbërje prej 3 anëtarëve, më mandat 2 vjeçar, më përfaqësim gjinor (anëtarët nuk mund të jenë zyrtarë që kanë marrë pjesë në komisionin vlerësues).
2. Përveç anëtarëve të rregullt kryetari duhet të parasheh më vendim edhe një (1) anëtarë rezervë i cili do të zëvendësoj në rast nevojë anëtarin komisionit cili ka konflikt interesi apo për ndonjë arsye mund të mungoj në ditët e punës së komisionit.
3. Ankesa ndaj vendimit për mes ndarje të subvencioneve i parashtrohet komisionit të ankesave sipas afatit të përcaktuar nga komisioni vlerësues i cili nuk mund të jete me i shkurtër se tre (3) e jo me i gjatë se shtatë (7) dite pune.

Neni 9 Afatet dhe shqyrtimi i ankesave

1. Komisioni i ankesave vendos mbi ankesën brenda pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të saj.
2. Komisioni i ankesave mban procesverbal për procesin e trajtimit të ankesave dhe vendimmarrjes.
3. Vendimi i komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurën administrative, dhe duhet t'i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe komisionit vlerësues.

Neni 10 Zbatimi i vendimit

1. Vendimi i Kryetarit për ndarjen e subvencioneve bëhet i zbatueshëm pasi të përfundon punën komisioni i ankesave nëse paraprakisht është parashtruar ankesa në thirrjen publike.

Neni 11 Shpallja publike për ndarjen e subvencioneve

Procesi i ndarjes së subvencioneve bëhet përmes shpalljes publike e cila qëndron e publikuar së paku 15 ditë kalendarike në ueb-faqen e Komunës, në tabelat e shpalljeve, si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e Komunës.

Neni 12 Kontrata për subvencionim

Komuna lidhë një kontratë me shkrim me përfituesin e subvencioneve brenda 90 ditësh nga dita e mbylljes së thirrjes publike.

Neni 13 Subvencionet për arsim

1. Komuna ndan subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) bursa për student;
- b) bursa për nxënës të shkollave të mesme;
- c) bursa për shkollim deficitar;
- d) bursa për nxënës me nevoja të veçanta;
- e) gara apo kuize (aktivitete jashtësimore);
- f) botimin e librave/revistave;
- g) nxënësit që kanë treguar rezultate të mira në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Kryetari i Komunës më vendim të veçantë përcakton shumën e subvencionit dhe kriteret për dhënie e bursave për çdo vit fiskal duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) notën mesatare
- b) gjendjen e vështirë ekonomike dhe sociale;
- c) fëmijë pa prind.
- d) fëmijë të dëshmoreve
- e) fëmijë të martireve
- f) fëmijë të invalidëve të luftës;
- g) personat me aftësi të kufizuara: 15 pikë.
- h) Në kushtet e barabarta siç e parashih ligji fëmijët e dëshmoreve, invalidëve dhe veteraneve të UÇK-së përfitojnë drejtpërdrejt.

3. Dokumentet e nevojshme për aplikim përcaktohen me thirrjen e Konkursit Publikë

4. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës, nëse brenda vitit të njëjtë akademik apo kalendarik nëse i njëjti ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga niveli qendror (Universiteti Publik dhe Ministria e Arsimit) ose ndonjë donator tjetër për fushën e njëjtë.

Neni 14 Subvencionet për zhvillim ekonomik

1. Komuna ndan subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) zeje bashkëkohore dhe tradicionale;
- b) agrobiznes;
- c) teknologji informative;
- d) ndërmarrje publike;
- e) biznes inovativ;
- f) ndërmarrje sociale;
- g) aktivitetet e shoqatave që ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin;
- h) inkubatorët e biznesit;
- i) bizneset e reja ose fillestare;

2. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunën e Skenderajt, dhe që nuk kanë obligime financiare të pa paguara ndaj Komunës dhe ATK-së.

3. Komuna u jep përparësi rasteve specifike si në vijim:

- a) bizneseve prodhuese
- b) përpunuese
- c) shërbyese që gjënëruan punësim;
- d) grave, të rinjve
- e) veprimtarive në zona rurale
- f) personave me nevoja të veçanta
- g) minoriteteve etnike;
- h) OJQ-ve të cilët aplikojnë me projekte biznesi.

4. Dokumentet e nevojshme për aplikim përcaktohen në Thirrjen (Konkursin) Publike

Neni 15

Subvencionet për bujqësi

1. Komuna ndan subvencione për bujqësi duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) projektet e fermerëve
- b) shoqatave bujqësore
- c) kooperativave bujqësore në fushat bujqësore me prioritet për Komunën;
- d) organizimin e panairëve, seminareve, vizitave studimore;
- e) mbështetjen e projekteve, me bashkëfinancim;
- f) projekte në sektorin e pylltarisë.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve për bujqësi, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi:

- a) pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim me 20% të vlerës me përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe;
- b) grave, të rinjëve, personave me nevoja të veçanta dhe minoriteteve etnike.

3. Dokumentet e nevojshme për aplikim paraqitën në Thirrjen (Konkursin) Publike

Neni 16

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Komuna ndan subvencione për shëndetësi dhe mirëqenie sociale duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) rastet e renda shëndetësore;
- b) rastet e renda sociale
- c) Subvencionimin e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së
- d) trajtimin në institucionet private vendore (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike)
- e) familjet me përkujdesje të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe ndihmohen familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara)
- f) gjendjen ekonomike të vështirë
- g) gjendjen të vështirë sociale.
- h) gjendjen të vështirë sociale dhe shëndetësorë
- i) çështjen e banimit;
- j) fatkeqësitë natyrore;
- k) gjendjen ekonomike të vështirë sociale, shëndetësorë dhe që kanë në familje të paralizuar, handikap apo të palëvizshëm.
- l) fushatat e vetëdijesimit për shëndetin publik.

2. Dokumentet e nevojshme për aplikim paraqitën në Thirrjen (Konkursin) Publike ndërsa rastet individuale shëndetësorë në kërkesë i dorëzojnë dokumentet e nevojshme në konsulta me drejtorinë përkatëse

3. Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, mbështeten projektet dhe aktivitete si në vijim:

- a) trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve profesionale brenda dhe jashtë Kosovës
- b) veprimtarit botuese dhe hulumtuese në fushën e shëndetësisë, dhe mirëqenës sociale, publikimet shkencore, hulumtimet shkencore dhe të ngjashme;

- c) aktivitetet edukative – shëndetësore dhe sociale me grupet e cenuara ose të marginalizuara, veçanërisht me grup- moshat parashkollore, shkollore dhe të rinjve si dhe të moshuarave pa përkujdesje familjare. ;
- d) tek aktivitetet edukative, për bazë do të merret numri i përfituesve të drejtpërdrejtë, si dhe qëndrueshmëria e projektit edhe pas përfundimit të projektit.

4. Të drejtë aplikimi për përfitimin e ndihmës momentale dhe të njëhershme, kanë gjitha Familjet e Dëshmoreve, Invalidët e UÇK-së, Veteranët e UÇK-së dhe familjet apo individët sipas Ligjit për Skëmën e Ndihmës Sociale në Kosovë, dhe individ dhe familje në nevojë me kushte të rënda ekonomike dhe sociale, të cilat për shkak të kriterëve nuk janë përfshirë në ndihma sociale.

5. Kërkesa për ndihmë momentale të njëhershme e bërë nga individ/familja dorëzohet tek Qendra për Punë Sociale (QPS)/njësia përkatëse, vetëm një herë në vit përjashtuar rastet e fatkeqësive natyrore, brenda (60) ditë, pas momentit të ndodhjes së rastit të jashtëzakonshëm.

6. Krahas kërkesës për ndihmë momentale të njëhershme parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë këto dokumente:

- a) dokumentin e identifikimit;
- b) kopjen e leje qëndrimit (për shtetasit e huaj; azilkërkuesit refugjatet dhe personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme);
- c) vërtetimin e llogarisë bankare;
- d) certifikatën e vdekjes për anëtarët e familjes;
- e) procesverbali për dëmet e shkaktuara, apo raportin e hartuar nga komisioni profesional për pasojat nga zjarri, vërshimi, tërmeti fatkeqësitë elementare etj;
- f) procesverbalin e policisë për paraqitjen e humbjes së dokumenteve së bashku me para ose ndonjë fakt tjetër;
- g) konstatimi nga kolegji i mjekëve apo flete lëshimin e spitalit, dhe dëshmi për shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet e tjera.

Neni 17

Qiraja për pagesë familjeve në gjendje të rëndë sociale të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit

1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës në planifikimin buxhetor numrin e familjeve apo individëve përfituesë për pagesën e qirasë me gjendje të rëndë ekonomike, të cilët nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit dhe nuk e përballojnë pagesën e qirasë.

2. Të drejtën e subvencionit e kanë banoret rezident, në Komunën e Skenderajt, qiraja e cila nuk mund të kalojë shumë prej njëqind e shtatëdhjetë e pesë (175) € për një (1) muaj.

3. Përparësi në për zgjedhjen e familjeve për pagesë të qirasë kanë:

- a) statusi i banimit;
- b) lartësia e të ardhurave;
- c) gjendja shëndetësore;
- d) invaliditeti;
- e) struktura e familjes; (familjet ku kryefamiljari është grua, fëmijët me statusin e jetimit dhe bashkëshorti/ja e shkurorëzuar që ka në përkujdesje fëmijë);
- f) familjet që kanë persona me nevoja të veçanta.

Neni 18

Afati për pagesën e qirasë së banimit

1. Pas aprovimit të propozimeve nga Kryetari i Komunës, Drejtori i DSHMS-së, lidhë kontratë me pronarin e banimit ku përfitues është familja apo individ i plotësues kriteret sipas kësaj rregullore.
2. Kontrata lidhet në afat një (1) vjeçar me mundësi vazhdimi, por jo me tepër se 18 muaj
3. DSHMS e njofton përfituesin së paku 60 ditë para përfundimit të kontratës së fundit sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 19

Rastet e shkëputjes së subvencionit të qirasë

1. Palës përfituese i ndërpritet e drejta për pagesë të qirasë kur:
 - a) qiramarrësi ka bërë deklaram të rrejshëm për të ardhurat;
 - b) qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk e ka njoftuar organin kompetent të Komunës;
 - c) qiramarrësi ja lëshon banesën me qira palës së tretë;
 - d) qiramarrësit i përmirësohet gjendja ekonomike, të cilin fakt e vlerëson në baza vjetore, komisioni vlerësues.
 - e) qiramarrësit i punësohet njeri nga anëtarët e familjes me pagë mbi minimale.

Neni 20

Subvencionet për Kulturë Rini dhe Sport

1. Komuna ndanë subvencione për Kulturë Rini dhe Sport duke përfshirë:

1.1. Kulturë

- a) Komuna ndan mjete financiare për Festivalin Folklorik "Rapsodia Shqiptare" i cili mbahet çdo vit tradicionalisht në datat 26, 27 e 28 nëntor.
- b) Organizimi i aktiviteteve nga fusha e artit muzikor, teatral, filmik, Art vizual-figurativ: krijimi i veprës së re, fuqizimi i artistëve të rinj, ekspozitë, hulumtim sektorial, instalime në hapësira publike, mbështetje të personave me nevoja të veçanta.

- c) Organizimi i koncerteve të muzikës artistike, koncerteve të ansambleve dhe grupeve muzikore të muzikës argëtuese, popullore, folklorike etj;
- d) Organizimi i aktiviteteve tradicionale dhe simpoziume të ndryshme;
- e) Subvencionimi i kërkesave për botimin dhe promovimin e librave, si dhe organizimi i mitingut të poezisë;
- f) Subvencionimi i shoqatave dhe grupeve të artistëve për hapjen e ekspozitave të veprave artistike;
- g) Manifestime: shënimi i datave historike, festave kombëtare dhe ngjarjeve tjera më rendësi në Komunën e Skenderajt;
- h) Subvencionimi i projekteve të trashëgimisë kulturore, fushata vetëdijesimi, pjesëmarrje në aktivitetet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, hulumtim i trashëgimisë, promovim i diversitetit kulturor, turizëm kulturorë, Platformë informative dhe inovacion teknologjik;
- i) Shpërblime vjetore: vepra më e mirë e vitit, krijuesit e vitit, ngjarja kulturore e vitit, projekti kulturor i vitit dhe operatori kulturor i vitit.

1.2. Rini:

- a) Përkrahja e Qendrës Rinore Publike të Licensuar nga Komuna e Skenderajt.
- b) Fuqizimi i organizatave rinore: mbështetja e aktiviteteve të OJQ-ve, promovimi i vullnetarizmit, integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara, pjesëmarrja në seminare, konferenca etj, brenda dhe jashtë vendit, mbështetja e ideve – projekteve të të rinjve si dhe promovimi i talentëve të rinj;
- c) edukimi jo formal: trajnime, punëtori, debate, tryeza, ligjërata, hulumtime, simpoziume, konferenca etj;
- d) shpërblime vjetore: vullnetar i vitit, ngjarja rinore e vitit, projekti rinor i vitit dhe organizata rinore e vitit.

1.3. Sport:

1.3.1 Përkrahja financiare e klubeve sportive

- a) Ngritja e kapacitetit në fushën e sportit: përkrahja e klubeve publike sportive përkrahja për sportistët kulmor dhe klubet e suksesshme, bashkëpunimi me organizatat e ndryshme sportive, vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të realizimit të projekteve për avancimin e trajnerëve, të cilat punojnë me grup mosha të ndryshme sportive, vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të realizimit të projekteve për avancimin e trajnerëve, të cilët punojnë me grup-mosha të ndryshme, ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive, si dhe aktivitete edukative me simpatizant me qëllim të evitimit të dhunës dhe kultivimit të vlerave fisnike të sportit;
- b) Organizime: trajnime, punëtori, debate, tryeza, ligjërata, hulumtime, simpoziume, konferenca, mbështetje të personave me nevojë të veçanta etj;

c) Shpërblime vjetore: sportistët/laureatët e sportit, ngjarja sportive e vitit, klubi sportiv i vitit dhe individët e inkuadruar në sport si punëtor profesional (trajner, refer, përzgjedhës, pedagog, punëtor sportiv, veteran të sportit, gazetar sportiv etj).

d) Mbështetje financiare e logjistike me hapësira sportive për Shoqatën e Pedagoqeve të Edukimit Fizik në garat e organizuara sportive në territorin e Komunës së Skenderajt, Garat republikane, Rajonale, Ndërkombëtare etj.

1.3.2 tërë procesi i ndarjes së subvencioneve për kulturë, rini dhe sport do të bëhet përmes platformës digjitale të Komunës së Skenderajt. Procesi nënkupton:

a) shpalljen e thirrjes: titulli, qëllimi, kriteret, dokumente e detyrueshme për aplikim, afati i përfundimit të thirrjes dhe kontakti;

b) aplikimi me projekte: regjistrimi i llogarisë së aplikuesit (person fizik apo juridik, plotësimi i aplikacionit, shënimi i datave të aktiviteteve të planifikuara, plotësimi i dokumenteve të detyrueshme dhe të kërkuara sipas thirrjes;

c) vendimi: shqyrtimi i listës së rekomanduar për mbështetje, miratimi i projekt propozimeve për mbështetje financiare, shpallja e listës së përfutuesve.

1.3.3. Kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim, pika a), paragrafi 5 i këtij neni do të përcaktohen në çdo thirrje.

1.3.4. Në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

a) Projekti i cili ka vazhdimësi dhe në të janë përfshirë pjesëtar të tjerë të Komunitetit;

b) Projekti për të cilin kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;

c) Projekti i cili mund të gjenerojë hyra financiare për kërkuarësin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme.

1.3.5. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë:

a) Projekt propozimin;

b) Personat përfutues

c) Pjesëmarrësit në Projekt - propozim

d) Plotësimin e aplikacionit digjital apo edhe me kopje fizike të dorëzuar pran zyrave të arkivit në komune;

e) Dokumentin identifikues;

f) Certifikatën e regjistrimit (për persona juridik);

g) Certifikatën e numrit fiskal (për persona juridik);

- h) Konfirmimin nga banka për gjyrollogarin e aplikuesit bashke me gjendjen e llogarisë bankare;
- i) Dëshminë për fondet e siguruara nga donatorët.
- j) Raportin mbi garat e zhvilluara me të gjitha kategoritë sportive.
- k) Raportin e projektit të vitit paraprak së bashku me raportin financiar të llogarisë bankare
- l) Raportin e auditimit (auditor i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi) të jashtëm për klubet që përfitojnë shumën mbi pesë (5) mijë euro brenda një viti kalendarik.
- m) Dokumentet që kërkohen sipas kriterëve në thirrjet e publikuara.
- n) Personat përgjegjës për realizimin e projektit sipas thirrjes publike nga organizatat sportive duhet të caktohen paraprakisht.

1.3.6 Për të gjitha kategoritë që i nënshtrohen thirrjeve publike vlejné dispozitat e nenit pesë (5) pika 3.

1.3.7. Klubet sportive obligohen që gjatë thirrjes publike të paktën një (1) herë të dorëzojnë dokumentet dhe aktetë normative sipas Udhëzimit Administrativ 03/2015 Për Themelimin dhe Regjistrimin e Klubeve Sportive, nenin 6 dhe nenin 7 të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 21

Raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve

1. Përfituesit obligohen që pas marrjes së subvencionit, të dorëzojnë në Komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare, ashtu siç janë kërkuar në projekt propozim (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve).

2. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë kalendarike pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen në mes të palës përfituese dhe Komunës.

3. Raportin nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohet dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e Komunës.

Neni 22

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

1. Komuna bën monitorimin cakton menaxher apo mbikëqyrës për secilën kontratë të secilës thirrje publike dhe inicion auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve për ndarje të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fusha të bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik.

2. Monitorimi sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet në periudhën kohore deri në një (1) vit nga data e fillimit të implementimit të projektit përfitues të subvencionit.

3. Obligohet përfituesi që deri në dhjetë (10) dite para fillimit të aktivitetit të parapare në projektin përfitues ta njoftoj zyrtarin përgjegjës të fushës përkatëse në DKRS për kohën

dhe vendin e mbajtjes dhe datat e përfundimit sipas planit të realizimit të projektit jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) dite nga dita e nënshkrimit të kontratës.

4. Zyrtari përgjegjës i fushës përkatëse sipas aktiviteteve dhe kontratës përgatit raport me shkrim të detajuar dhe përmes protokollit njofton Kryetarin e Komunës, DKRS-në për ecurinë e realizimit të projektit përfitues dhe përmbushjen e kontratës bashkë me rekomandimin për ecurinë e mëtejme të projektit përfitues.

Neni 23

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon në ueb faqen e saj, në tabelën e shpalljes, si dhe në vendet e frekuentuara, listën e përfituesve, e cila përmban emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shuma që u janë ndarë.
2. Komuna përjashton rastet e publikimit të subvencioneve për gjendje të rendë shëndetësore.

Neni 24

Ndarjen e subvencioneve nga Kryetari i Komunës

1. Sipas LIGJ Nr. 04/L-075 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/24 PËR SPORT si dhe LIGJ NR. 06/L-115 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/24 PËR SPORT I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-075 neni 65.1, Bazën e financimit të sportit dhe të nevojave publike e shtetërore, e përbëjnë mjetet financiare që sigurohen nga buxheti i Kosovës. Siç parashihet në Nenin 65.2. (Ligji Nr. 04/L-075) Komunitat nga buxheti i tyre ndajnë mjete për financimin e sportit, mbështetur në këtë dispozitë si dhe në dispozitat të Ligjit 03/L-040 Kryetari i komunës me vendim ndan mjete financiare sipas mundësive buxhetore për klubet Sportive të Komunës së Skenderaj pa thirrje publike, pa kufizim të shumës së subvencionit në çdo kohë vetëm me kërkesë të klubeve përkatëse të sportit përkatës, të arsyetuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini e Sporte mbi bazën e raporteve të garave dhe nevojave financiare të klubit përkatës në kampionatet vendore, Kupa dhe gara ndërkombëtare të të gjitha sporteve individuale dhe kolektive në konkurrencën e meshkujve dhe femrave.
2. Kërkesa e klubit të sportit përkatës duhet të përmbajë raportin narrativ mbi garat e zhvilluara, pjesëmarrësit dhe anëtarët e të gjitha kategorive të sportit përkatës në kampionatin përkatës, raportin e auditorit të jashtëm, raportin e garave të zhvilluara, numrin e ndeshjeve të zhvilluara bashkë me kalendarin e ndeshjeve që kanë me u zhvilluar në vazhdim, renditjen tabelorë dhe kalendarin dativ të garave për secilën kategori në sportin përkatës, kohën e përgatitjeve para-kamionale dhe datat e fillimit të kampionateve individuale dhe kolektive, kohën e transferove dhe përgatitjet jashtë vendi, raportin bankare dhe të dhënat mbi llogarinë bankare, gjendjen e llogarisë bankare, numrin e personave të paguar nga klubi, obligimet e

klubit listën me emra, mbiemra dhe numër të ID (librezave) të lojtarëve të klubit për secilën kategori garuese.

3. Kryetari me vendim ndan mjete për realizimin e aktivitetit kulturor gjithëkombëtar Festivalin Folklorik "RAPSODIA SHQIPTARE" aktivitet kryesor i komunës së Skenderajt.

Neni 25

Dispozitat kalimtare dhe shfuqizuese

1. Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore janë Kryetari i Komunës, Drejtoritë dhe Zyrat të cilat ndajnë subvencione.


2.. Me miratimin e kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja për ndarjen e subvencioneve Nr.1-110-33792 e datës 16.06.2015.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës së Skenderajt.





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government

Për:	Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt Fatbardha Haliti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MF-së.	
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL	Datë: 28.01.2021 Nr.453-956
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

Inderuar Kryetar,

Enderuara Kryesuese,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Rregullore Nr. 01-400/01-0051689/20 për ndarjen e subvencioneve, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, dhe i nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Skenderajt, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave.

Vjosa Ahmetaj

From: Razije Murtezaj
Sent: 27 January 2021 14:03
To: Vjosa Ahmetaj
Cc: Venera Çerkini; Bahrije Berisha; Florije A. Gashi; Antoneta Shtufi
Attachments: 2225 MAPL Shkrese percjellese e ligjshmerise se aktit KK Skenderaj MF-02....pdf

E nderuar,

Ne kemi pranuar aktin e Komunes se Skenderajt perkatesisht draft Rregulloren per ndarjen e Subvencioneve te komunës se Skenderajt, vlerësoj se rregullorja e lartcekur nuk bie ndesh me legjislacionin qe eshte ne fushëveprimin e Ministrise se Financave. Departamenti i Ndihtes Shtetërore në kuptim të përmbushjes së nenin 3, paragrafit 1, vlerëson se akti i komunës duke u bazuar në Vendimin për Vendimet, plotëson kriteret për ti'u nënshtruar rregullave të ndihmës shtetërore, sipas Ligjit Nr. 05/L-100 Për Ndihtën Shtetërore, nenit 7.

Për zbatim të këtij ligji (neni 7), Komuna e Skenderajt obligohet ta zbatoj Rregulloren (QRK) Nr. 04/2020 Për Ndihtën De Minimis.

Çdo të mirë!

Razije Murtezaj